



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:145136

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05873150

P.nr.2021:145137

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri në lëndën penale ndaj të pandehurit S.T., me vendbanim në Ferizaj rruga “ ... ”, rrugica ..., pikërisht në shtëpinë e qiradhënësit K.S. (më parë ka jetuar në rrugën “... ” në Ferizaj, për shkak të veprës penale “Kanosja “nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II Nr. 984/2021 të datës 05.07.2021, ku ka propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtorë për veprën penale të cilën ia vë në barrë, dhe, njëkohësisht në pajtim me neni 512 të KPP-ës dhe nenin 86 paragrafi 1 të KPRK-së, i ka propozuar Gjykatës që të njëjtit ti shqiptojë, masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, ku pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, të pandehurit S.T., Dr. M.Q., psikiatër dhe përfaqësueses së të dëmtuarit Av.Vildane Hamiti me datë 24.06.2024 mori dhe publikisht shpalli, kurse me datën 28.06.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Kundër të pandehurit:

- **S.T.**, me vendbanim në Ferizaj rruga “ ... ”, rrugica ..., pikërisht në shtëpinë e qiradhënësit K.S. (më parë ka jetuar në rrugën “...” në Ferizaj, i lindur më ..., nga i ati Isuf dhe e ëma F. e gjinisë R. në Ferizaj, ka të kryer shkollën fillore i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Kosovës, gjendet në liri me nr. personal :...,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

- Me datë 27.06.2021, gjate intervalit kohor 17:00-21:00, në Ferizaj, i pandehuri pas një mosmarrëveshje lidhur me një çështje pronësor me te dëmtuarin A.H. përmes numrit të telefonit 04./.../... dhe komunikimit në aplikacionin “ Viber ”, në ata mënyrë që me qëllim të frikësimit dhe shkakimit të ankthit e ka kanosur te dëmtuarin fillimisht me fjalët “ kam me ju kalle me fëmijë e me krejt , në shpi ka me te hi pa paralajmërim krejt me dinamit “ gjakun ki me pagu me gjak “e me pas i ka dërguar edhe një fotografi ku vërehet një dore e gjakosur dhe shkruan gjakun ki me pagu me gjak , borxh së të kom pas me ma marr token me zor me ,ç raste kjo kanosje ka shkakuar shqetësim frik dhe pasiguri tek i dëmtuari dhe familja e tij.

- me këtë ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata konform neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 18, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69,70, 71, 72, 79, 86,të KPRK-së, si dhe neneve 364 460 par. 1, të KPPRK-së e:

G J Y K O N

Të pandehurit **S.T.**, i shqipton dënim me burgim me Kusht në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve,dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga ditae plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i pandehuri nuk kryen vepër të re penale.

Në bazë të nenit 84 par. 1 pika 1.2 dhe 86 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPRK-së, nenit 514, par. 3,dhe 515 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i SHQIPTOHET:

MASA E TRAJTIM I DETYRUSHËM PSIKIATRIK NË LIRI

I. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri në Institucionin Shëndetësor për të pandehurin S.T., do të bëhet në Klinikën e Psikiatrisë në Ferizaj, duke filluar nga dita vijuese pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

II. OBLIGOHET i pandehuri që të paraqitet në Klinikën e Psikiatrisë në Ferizaj, që t’i nënshtrohet trajtimit psikiatrik, sipas rregullave të caktuara nga mjeku përkatës neuropsikiatri dhe psikiatri.

III. Klinika e Psikiatrisë në Ferizaj, është e obliguar që së paku 1 (një) herë në 6 (gjashtë)muaj ta njoftojë këtë gjykatë lidhur me gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit të lartpërmendur.

IV. Në rast se i pandehuri S.T., nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në

liri, kjo gjykatë, sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të Institucionit të Kujdesit Shëndetësor do ta zëvendësojë këtë masë me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim.

V. Kjo masë e shqiptuar ndaj të pandehurit do të pushoj kur trajtimi ose rehabilitimi me nuk janë të nevojshëm, por e njëjta nuk mund të tejkaloj dy (2) vite.

VI. I pandehuri S.T.i, është liruar nga detyrimi i pagesës së kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale dhe taksës së viktimave të krimit, pasi që nëse obligohet për pagesën e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit pasi që nuk punon dhe është gjendje jo të mirë shëndetësore dhe të vetmin burim të të ardhurave ka pranimin e Pensionit të Personave me Pa Aftësi të Përhershme në bazë të Vendimit i dt.01.10.2021 .

VII. I dëmtuari A.H., me vendbanim në rrugën “ ” në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II Nr. 984/2021 të datës 05.07.2021 për shkak të veprës penale “Kanosja “nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, kundër të pandehurit S.T., me vendbanim në Ferizaj rruga “ ... ”,rrugica ..., pikërisht në shtëpinë e qiradhënësit K.S. (më parë ka jetuar në rrugën “....” në Ferizaj, dhe me propozim, që të pandehurit ti shqiptojë, masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata me datë 24.06.2024 ka caktuar shqyrtimin gjyqësor ku ka ftuar edhe Dr. M.Q. ekspertin e psikiatrisë që të jep mendimin e tij lidhur me gjendjen shëndetësore të të pandehurit pasi që prokurori i shtetit në aktin akuzues ka propozuar që të pandehurit pasi që ta shpall fajtorë të i shqiptojë masë të trajtimit të detyrueshëm në liri meqenëse i njëjti ka pas edhe tretmanë të mëhersh Mjekësor dhe prokurori i shtetit në shqyrtimet gjyqësore ka propozuar që të thirret një ekspert për të dhënë mendimin e tij për gjendjen e tij shëndetësore se a është i aftë që të përcjellë seancë gjyqësore andaj Gjykata ka ftuar ekspertin e psikiatrisë M.Q..

Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor Dr. M.Q.- psikiatër deklaron se i pandehuri S.T. është i aftë të kuptojë për veprën për të cilën e ngarkon akuza, është i rregullt në marrjen e terapisë dhe vizitave specialistike, nëse ka nevojë për barëra i njëjti l'u përmbahet rregullave.

Gjyqtari i vetëm gjykues edhe ne shqyrtimin gjyqësor e udhëzon te pandehurin, konform nenit 319 par.1 të KPP-së se ka të drejtë për të mos u deklaruar për çështjen e tij, ose mos të përgjigjet në pyetje, nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminoj vetveten ose të afërmin, as të pranoj fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtoj aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

I pandehuri S.T. deklaron: i kam kuptuar në tërësi udhëzimet nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues, mbrojtjen do ta paraqes dhe do të deklarohej në lidhje me çështjen do të përgjigjem në pyetjet e gjykatës për mbrojtës nuk kam të angazhuar, mbrojtjen do ta jap vet ku prokurori i shtetit lexon aktakuzën me numër PP/II.nr. 984/21 e datës 05.07.2021

I akuzuari S.T., në shqyrtimin kryesor, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjyqtarit gjykues për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaron se: e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën më ngarkon akuza, është e vërtetë që ia kam shkruar ato fjalë të cilat janë të cekura në aktakuzë, kërkojë falje të dëmtuarit edhe pse nuk është prezent, premtoj se në të ardhmen nuk do të bëjë veprime të tilla apo të ngjashme, më asnjëherë nuk kam pas probleme me të, jam penduar dhe asgjë nuk kam asgjë të keqe me të.

Pasi që i akuzuari pranon fajësinë në fillim të shqyrtimit kryesor, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 322 paragrafi 1 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), vlerëson se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 paragrafi 2 të këtij Neni, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit: Raporti i Vlerësimit Psikologjik mbi gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin S.T., lëshuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike me numër 92/2 i datës 09.03.2021, Fletë lëshimi nga shërbimi spitalor dhe klinik universitar i Kosovës me numër .../62 i datës 24.03.2016, SMS si dhe foto ne mënyrë elektronike-Viber , Procesverbali mbi marrjen në pyetje i të pandehurit S.T. i dt.29.06.2021, Procesverbali mbi marrjen në pyetje i të dëmtuarit-dëshmitarit A.H. i dt.18.06.2021, Foto-dokumentacioni dhe shkresa tjera që gjenden në lëndë,, dhe konform të njëjtit nënë paragrafi 4, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Besnik Nuredini, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se në bazë të nenit 351 të KPPK-së, paraqes fjalën përfundimtare ndaj të akuzuarit S.T. për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par. 2 i KPRK-së. Mbetem pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale pasi që qysh në fillim të këtij shqyrtimi gjyqësorë i akuzuari e pranon fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon kjo akuzë, pasi që kjo aktakuzë është ngritur pas grumbullimit të provave të mjaftueshëm duke u bazuar në provat personale dhe materiale, andaj edhe një pranimi tillë është bërë në mënyrë vullnetare dhe Konform dispozitave të nenit 242 të KPPK-së, me të cilën edhe ne si prokurori u pajtuam me pranimin e fajësisë së të akuzuarit, andaj i propozoj Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë për veprën penale të cilën ia vë në barrë kjo akuzë dhe të i shqiptojë dënimi meritor sipas ligjit njëkohësisht i propozoj Gjykatës që të njëjtit të ti shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri e cila do të realizohet në mënyrë ambulatore në Qendrën e Shëndetit mendor në Ferizaj.

Përfaqësuesja e të dëmtuarit A.H., av. Vildane Hamiti në fjalën përfundimtare deklaron në këtë fjalë përfundimtare si përfaqësuese e të dëmtuarit pasi që tani më i akuzuari ka pranuar fajësinë i propozojmë Gjykatës që të njëjtit të i shqiptojë dënimin që është i paraparë me ligj për këtë vepër penale, e po ashtu nuk e kundërshtojmë propozimin e prokurorisë për caktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

I pandehuri S.T. deklaron: do i përmbahem masës, jam shfrytëzues i pensionit

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjyqësor ka vërtetuar këto gjendje faktike se i akuzuari S.T., ka kryer veprën penale, Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, gjendjen e tij të dobët ekonomike, të vetmin burim të të ardhurave ka pranimin e Pensionit të Personave me Pa Aftësi të Përhershme, sjelljet e tij tejet korrekte në gjykim, Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë shprehja e keqardhjes për rastin që i ka ndodhur, duke mos gjetur rrethana rënduese Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij do të parandaloj personat e tjerë

nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Prokurori i shtetit, në shqyrtimin gjyqësor, ka propozuar që pos shqiptimit të dënimit për veprën penale që akuzohet i pandehuri ti shqipton edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, e cila do të realizohet në mënyrë ambulatorë në Qendrën e Shëndetit Mendorë në Ferizaj.

Gjykata duke marr për bazë rrethanat dhe gjendjen e të pandehurit në momentin e kryerjes së veprës penale si dhe çrregullimet nga të cilat ai vuan e ka parë si të domosdoshme vendimin mbi masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, me qëllim të rehabilitimit të të pandehurit në mënyrë që të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit që i njëjti mos të kryej më vepra penale.

Gjykata konsideron se me zbatimin e kësaj mase i pandehuri do të përcillet dhe trajtohet nga ana e psikiatrit dhe psikologut me qëllim të parandalimit të përsëritjes së këtyre veprimeve, një gatishmëri të tillë e ka shfaqur edhe vet i pandehuri. Andaj nga arsyet e lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi – përkitazi me masën e trajtimit detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata në rastin konkret zbatoi nenin 18 të KPRK-së (Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074) e ku në paragrafin 1 të këtij neni thuhet se: Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet i paaftë mendërisht nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij/saj mendor dhe si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje të kuptojë natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij/saj ose nuk ka qenë në gjendje t'i kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij/saj apo të kuptojë se kryen vepërpenale. Tutje, paragrafi 2 i po këtij neni sqaron se: Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij/saj për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij/sajka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.

Gjykata po ashtu në rastin konkret zbatoi edhe nenin 515 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin specifikohet se: Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo

gjithashtu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri bazuar me dispozitat e neneve 84 dhe 86 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet nga neni 86 par.1 nën par.1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, kështu që duke marr parasysh të gjeturat nga ekipi i eksperteve të IPFK-së, si rekomandimet që rezultojnë nga ekspertiza e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, gatishmëria e të pandehurit që të shkoj rregullisht në konsulta psikiatrike dhe t'i përdor me rregull terapinë që do t'i rekomandohet nga mjeket si dhe duke marr parasysh gjendjen e tanishme shëndetësore dhe nevojat për trajtim adekuat që kishin me ndikuar në shërim dhe rehabilitimin e të pandehurit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga dispozitat e lartcekura vijmë në përfundim se kryesi i veprës penale llogaritet penalisht i përgjegjshëm pra i njëjti gjykohet për veprën penale të cilën e ka përfunduar në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendore, por një gjendje tillë merret parasysh kur gjykata vendos për kohëzgjatjen e sanksionit penal ose masës së trajtimit të detyrueshëm, andaj edhe gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, por si rrethanë lehtësuese morri për bazë gjendjen esenciale të zvogëluar.

Vendimi për lirim të pandehurit nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 452 par.4 të KPP-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë komfor nenit 462 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.2021: 145137 të datës: 28.06.2024

Zyrtare ligjore

Arbelinda Tahiri

Gjyqtari i vetëm gjykues

Adem Shabani

KESHILL JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.